REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____prot. **Prrenjas, më ___.___.2026**

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
SHPALLJE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
(Specialist(mbrojtje konsumatori) në Sektorin e bujqësisë ,turizmit, mbrojtja e konsumatorit, Drejtoria e Bujqësisë , Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave)

Lloji i diplomës "Teknologji Agroushqimore/ Mjekësi veterinare"
Niveli minimal i diplomes "Bachelor/Master Profesional/Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil",i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VI të VKM nr Nr. 243, datë 18.3.2015, **Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Prrenjas** shpall procedurat e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

Specialist(mbrojtje konsumatori) në Sektorin e bujqësisë ,turizmit, mbrojtja e konsumatorit, Drejtoria e Bujqësisë , Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Kategoria e pagës IV, Klasa 3

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele,pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	**06 Nëntor 2026**
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHERBIMIT CIVIL	**11 Nëntor 2026**

PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN MË SIPËR ËSHTË:

1.Ndjek punën që bëhet në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësise dhe mbrojtjes së mjedisit nga institucionet shteterore a private që veprojnë në territorin e bashkisë.

2.Merr të gjitha masat për parashikimin në buxhet të të ardhurave dhe shpenzimeve që krijohen në fushën e shëndetësisë për institucionet që administrohen nga bashkia dhe investimeve për institucione të reja dhe ndjek plotësimin e buxhetit të miratuar për të gjithë zërat e strukturës buxhetore.

3.Ndjek zbatimin e vendimeve dhe urdhëresave që harton Këshilli Bashkiak në fushën e shëndetësisë, higjenës, mjedisit, orarit të punës, etj.

4.Parashikon masat e nevojshme për rastet epidemike, sëmundje ngjitëse në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe ndjek plotësimin e tyre nga subjektet përkatëse. Mbështet organet e specializuara të shëndetësisë në plotësimin e detyrave në raste epidemish.

5.Ndjek dhe organizon punën, merr masa për zbatimin e rregullores për shërbimin shëndetësor në institucionet fëminore, çerdhe, etj.

6. Kryen cdo detyrë tjetër me urdhër të eprorit.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

Arsimi:

Arsimi i lartë – Diplomë Bachelor/Master profesional/Master shkencor në Teknologji Agroushqimore/ Mjekësi veterinare. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).

Përvoja :

- Të ketë 1 vit eksperiencë në administratë.

Tjetër:

- Të ketë njohuri mjaft të mira të gjuhës angleze, preferohet njohja e një gjuhe të dytë të BE.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, dokumentat si më poshtë:
a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta
b-Fotokopje të diplomës
c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi.
i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.11.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **09.11.2026**, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen e internetit të Bashkisë, **listën e kandidatëve** që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, vendin, daten dhe oren e sakte.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:
a) Ligjin Nr. 152/2013,"Për nëpunësin civil", i ndryshuar,
b) Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003,"Për rregullat e etikës në administratën publike".
c) Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar
d) Ligjin Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
e) Ligjin Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatoreve"
f) Ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin"

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën,

si dhe vlerësimet pozitive.
Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:
a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"
http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të Bashkisë.
Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkise Prrenjas, duke filluar nga data 11.11.2026

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:
a - Të jetë shtetas shqiptar;
b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

Arsimi:

Arsimi i lartë – Diplomë Bachelor/Master Profesional/Master Shkencor në Teknologji Agroushqimore/ Mjekësi veterinare. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).

Përvoja :

- Të ketë 1 vit eksperiencë në administratë.

Tjetër:

- Të ketë njohuri mjaft të mira të gjuhës angleze, preferohet njohja e një gjuhe të dytë të BE.

Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard

b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen zyrtare elektronike të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijimësi udhëzimet online.

http://hrm.gov.al/Register.aspx

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online ose pranë Bashkisë Prrenjas për procedurën e pranimit në shërbimin civil duhet të bëhet brenda datës *11.11.2026*

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 23.11.2026 Njbnj ne Bashkine Prrenjas do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta për proceduren e pranimit ne sherbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet

testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Prrenjas, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail).*

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:
a) Ligjin Nr. 152/2013,"Për nëpunësin civil", i ndryshuar,
b) Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003,"Për rregullat e etikës në administratën publike".
c) Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar
d) Ligjin Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
e) Ligjin Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatoreve"
f) Ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.
Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
b- Intervisten e strukturuar me goje qe konstiton ne motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrieren , deri ne 25 pike.
c- Jeteshkrimin , qe konstiton ne vleresimin e arsimimit te pervojes e te trajnimeve , te lidhura me fushen, deri ne 15 pike.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ Bashkia Prrenjas do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail), Bashkia Prrenjas* do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit nga jashtë, do të marrin informacion në faqen zyrtare te Bashkise Prrenjas, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;